

Vendim nr. 11 datë 20.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Sonila Bejtja,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 20.01.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (E) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERDI PRIFTI

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes civile në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me palë ndërgjyqëse, kërkuar Erdi Prifti, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021 të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Përshpejtimin e procedurave për hetimin sa më të shpejtë të çështjes penale për sa i përket nr. 102 të vitit 2021, duke mbyllur hetimet në një kohë sa më të shkurtër.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes civile në shqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë, me palë ndërgjyqëse, kërkuar Erdi Prifti, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes civile në gjykatën e shkallës së parë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërcituara.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Sipas akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi Erdi Prifti është një nga palët ndërgjyqëse (në cilësinë e palës paditëse) në procesin gjyqësor që po zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt kthimin tërësisht të pasurisë trashëgimore dhe lirim të dorëzimit të saj, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike, kontrata shitblerjeje.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbi bazën e materialit kallëzues të paraqitur nga kërkuesi Erdi Prifti, ka regjistruar procedimin penal nr. 34, datë 08.01.2021 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 1, i Kodit Penal (KP). Me vendimin e prokurorit të datës 08.02.2021, aktet e këtij procedimi i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për kompetencë tokësore, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 102 të vitit 2021.

3. Me vendimin e datës 14.04.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes civile ku kërkuesi është palë, deri në përfundimin e çështjes penale që i përket procedimit penal të mësipërm. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 48, datë 23.06.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë.

4. Me kërkesën e datës 08.06.2021, pala paditëse në procesin gjyqësor civil, ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, me pretendimin se pasuria mund të tjetërsohej përsëri dhe se ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur ose i vështirë, për shkak se çështja civile e themelit është pezulluar dhe nuk dihet kur do të rifillojë gjykimi i saj. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 4, datë 10.06.2021, Gjykata e Apelit Korçë ka

vendosur të shpallë moskompetencën lëndore dhe t'i dërgojë aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë si gjykata kompetente.

5. Kundër këtij vendimi paditësit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, për të cilin, me vendimin nr. 00-2021-2165, datë 06.12.2021 të Kolegjit Civil, është vendosur mospranimi, duke e konsideruar vendimin për shpalljen e moskompetencës si vendim të ndërmjetëm, kundër të cilit mund të bëhet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.

6. Me kërkesën e datës 14.02.2022, paditësit kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 35, datë 29.03.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se përderisa ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë është gjykuar nga Gjykata e Lartë, nuk arrihet të provohet më interesi i drejtpërdrejtë i kërkuësve në drejtim të përsheptimit të procedurave nga vendimi objekt kërkesë.

7. Me kërkesën e datës 14.03.2022, kërkuesi Erdi Prifti i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë me kërkesë për informacion në lidhje me ecurinë e hetimeve të procedimit penal nr. 102 të vitit 2021.

8. Me kërkesën e datës 20.04.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në mbështetje të neneve 399/1, 399/2, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 2, 399/5, 399/6 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021 dhe përsheptimin e procedurave për hetimin sa më të shpejtë të kësaj çështjeje. Në kërkesë është pretenduar se çështja penale është bërë pengesë për ushtrimin e të drejtave të tij dhe të paditësve të tjerë në procesin civil të pezulluar deri në përfundimin e shqyrtimit të saj. Ai ka pretenduar se edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit e 3 muaj, prokurori nuk ka mbyllur ende hetimet, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt, në drejtim të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve.

9. Me e-mail-in e datës 10.05.2022 të sekretarisë së gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi është njoftuar se kjo çështje është regjistruar dhe shortuar e se ndodhet për shqyrtim te gjyqtari.

10. Me kërkesën e datës 27.07.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë, në mbështetje të neneve 399/1 e vijues të *KPC*-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të kërkesës së regjistruar në gjykatën e shkallës së parë, si edhe

përshejtimin e procedurave, duke pretenduar se ajo gjykatë ka shkelur afatin 45-ditor të përcaktuar në nenin 399/7, pika 2, të KPC-së.

11. Me kërkesën e datës 12.12.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të sipërcituar të tij.

II

Pretendimet e kërkuetit

12. **Kërkuesi Erdi Prifti** ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, të së drejtës për shqyrtimin brenda afatit të arsyeshëm të kërkesave të paraqitura në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të apelit, si dhe përshejtimin e këtyre procedurave. Në kërkesë është parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, sa vijon:

13.1. Kërkuesi provon interesin e tij, pasi është kallëzues dhe palë paditëse në procesin civil dhe nuk ka mjet tjetër ligjor përveç ankimit kushtetues individual.

13.2. Mospërfundimi i shqyrtimit të çështjes penale është bërë pengesë për ushtrimin e të drejtave juridike civile, si palë paditëse në procesin gjyqësor të pezulluar. Megjithatë, prej më shumë se 7 muaj nuk ka asnjë vendim nga gjykatat e zakonshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka njoftuar ende mbi ndonjë seancë gjyqësore ose vendim. Gjykata e Apelit Korçë ka njoftuar kërkuetin me fletë-njoftimin e datës 24.10.2022, për shqyrtimin e kësaj çështjeje në dhomën e këshillimit në datën 01.11.2022, por gjykimi nuk është zhvilluar për mosformim të trupit gjykues dhe nuk rezulton të jetë caktuar seancë tjetër. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës së apelit, me kërkesën e datës 17.01.2023, për përshejtimin e shqyrtimit të kërkesës së tij. Gjykatat kanë shkelur afatin procedural prej 45 ditësh për shqyrtimin e këtyre kërkesave, të përcaktuar në nenin 399/7, pika 2, të KPC-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuetit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike,

mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Neni 134, pika 2, i Kushtetutës përcakton, ndër të tjera, se subjektet e përcaktuara në shkronjën “i” të pikës 1 të saj mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat tyre. Në këtë kuptim, individët duhet të provojnë përpara Gjykatës se shkeljet e pretenduara janë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të kundërshtuar dhe se janë viktimat e shkeljes të së drejtës kushtetuese.

17. Kolegji vëren se kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt nga gjykata e shkallës së parë, e vënë në lëvizje me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm nga prokuroria gjatë hetimeve të procedimit penal ku ai është kallëzues, e më tej edhe të vendimit të gjykatës së apelit, e vënë në lëvizje për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykatën e shkallës së parë. Në thelb, kërkuuesi pretendon mosrespektimin e afatit 45-ditor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit Korçë për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

18. Dispozitat e KPC-së parashikojnë mjetet juridike për t’u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Ato përcaktojnë se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), me çfarë mjeteve mbrohesh nga cenimi: kërkesa për përshpejtim (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8), etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete juridike me qëllim që individit t’i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

19. Në rastin konkret kërkuesi, pasi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në lidhje me hetimin e çështjes penale ku ai është kallëzues, i është drejtuar gjykatës së apelit në kuptim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Duke qenë se nuk ka marrë përgjigje për këtë kërkesë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, edhe pse nuk kishte ende një vendim përfundimtar dhe të formës së prerë në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e procedurave, sipas nenit 399/8 të KPC-së, pra edhe pse kërkesa e tij për mosgjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, ishte ende në shqyrtim në gjykatat e zakonshme.

20. Për qëllime të shqyrtimit të kësaj çështjeje, u kërkua informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet gjykimi i kërkesës së paraqitur nga kërkuesi në atë gjykatë, nga ku rezulton se me vendimin e saj të datës 14.12.2022 është vendosur rrëzimi i kërkesës me objekt *“Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale”*.

21. Parë në vështrim të ecurisë së deritanishme të çështjes, Kolegji thekson se në thelb, kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave është mjet juridik në dispozicion të individit për të garantuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Në këto lloj rastesh, Gjykata nuk vihet në lëvizje thjesht dhe vetëm për të kontrolluar efektivitetin e mjetit juridik që individi ka në dispozicion për të parandaluar ose riparuar shkeljen e së drejtës kushtetuese, por për të kontrolluar nëse individit i është shkelur ose jo vetë e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Thënë ndryshe, Gjykata, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, shqyrton pretendimin kryesor që lidhet me kohëzgjatjen e gjykimit të themelit që zhvillohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndërsa procedurat dhe vendimet gjyqësore që shqyrtojnë kërkesat për përshpejtimin e procedurave janë në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese dhe nuk mund të qëndrojnë në mënyrë autonome nga pretendimi kryesor.

22. Në kontekst të sa më sipër, dhe në kushtet kur kërkesa e kërkuesit për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave është marrë tashmë në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë dhe ka një vendimmarrje për rrëzimin e saj, si dhe duke qenë se kërkuesi në ankimin kushtetues i ka mbështetur argumentet e tij pikërisht në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, e pretenduar e cenuar për shkak të mos gjykimit brenda afatit të arsyeshëm të kërkesës për konstatimin dhe përshpejtimin e procedurave, Kolegji çmon se ai nuk arrin të provojë më interesin e tij sipas objektit të këtyre kërkesave.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se çështja nuk i plotëson kriteret për shqyrtimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.